



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla - ZRRE/Nr. 03/2022

RREGULLA NR. 03/2022 PËR PROCEDURËN E AUTORIZIMIT PËR NDËRTIMIN E KAPACITETE TË REJA GJENERUESE, SISTEMEVE TË REJA TË TRANSMISIONIT DHE DISTRIBUCIONIT TË GAZIT, PËRFSHIRË INTERKONEKTORËT, TUBACIONET DIREKTE PËR ENERGJI TERMIKE DHE LINJAT DIREKTE TË ENERGISË ELEKTRIKE DHE TUBACIONET DIREKTE TË TRANSMISIONIT TË GAZIT NATYROR

(PROCEDURA E AUTORIZIMIT PËR NDËRTIMIN E PROJEKTEVE TË ENERGISË)

Prishtinë, 16 Nëntor 2022



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në pajtim me nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, neni 25, neni 26, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 dhe neni 43, paragrafi 1 dhe paragrafi 4 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. nr. 05/L-084, në seancën e mbajtur më 16.11.2022, miratoi:

RREGULLËN PËR PROCEDURËN E AUTORIZIMIT PËR NDËRTIMIN E KAPACITETE TË REJA GJENERUESE, SISTEMEVE TË REJA TË TRANSMISIONIT DHE DISTRIBUCIONIT TË GAZIT, PËRFSHIRË INTERKONEKTORËT, TUBACIONET DIREKTE PËR ENERGJI TERMIKE DHE LINJAT DIREKTE TË ENERGJISË ELEKTRIKE DHE TUBACIONET DIREKTE TË TRANSMISIONIT TË GAZIT NATYROR

(PROCEDURA E AUTORIZIMIT PËR NDËRTIMIN E PROJEKTEVE TË ENERGJISË)

**KAPITULLI I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Rregulle është të përcaktojë procedurën për lëshimin e Autorizimit për ndërtim të Kapaciteteve të Reja Gjeneruese, Sistemeve të Reja për Transmisionin dhe Distribucionin të Gazit, duke përfshirë Interkonektorët, Tubacionet Direkte për Energjinë Termike dhe Linjat Direkte të Energjisë Elektrike dhe Tubacionet Direkte për Transmisionin e Gazit Natyror.

**Neni 2
Fushëveprimi**

1. Kjo Rregull përcakton kriteret dhe procedurën për lëshimin e Autorizimit për ndërtim të Projekteve të Energjisë në Republikën e Kosovës.
2. Autorizimi për ndërtim të Projekteve të Energjisë merret në përputhje me kushtet e përcaktuara me këtë Rregull, ndërsa shqyrtimi i Aplikacioneve bazohet në kritere që mbështesin zhvillimin e një tregu konkurrues të energjisë dhe që nxisin investime për të garantuar sigurinë dhe stabilitetin e sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës.
3. Kjo Rregull nuk aplikohet për procedurën e tenderimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese siç është përcaktuar në Nenin 44 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084).
4. Kur shfrytëzohet një mekanizëm tjetër konkurrues siç janë ankandet për burimet e energjisë së ripërtëritshme nga një entitet i përcaktuar për të zgjedhur një investitor për ndërtimin e Kapacitete të Reja Gjeneruese të teknologjisë së ripërtëritshme, kjo Rregull zbatohet siç specifikohet këtu ose siç përcaktohet me legjislacion primar i cili rregullon mekanizmin mbi procedurën konkurruese.



Neni 3 Përkufizimet

1. Termet e përdorur në këtë Rregull kanë kuptimin e mëposhtëm:

- 1.1. “Aplikant” – çdo person fizik apo juridik, i themeluar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar apo shoqëri aksionare, që dëshiron të ndërtojë një Projekt Energjetik dhe që aplikon në ZRRE për Autorizim;
- 1.2. “Aplikim” – një kërkesë formale e përcjellur me dokumentet e përgatitura nga Aplikuesi që i dorëzon zyrtarisht në ZRRE për shqyrtim;
- 1.3. “Autorizim” – nënkupton vendimin e lëshuar nga ZRRE-ja, me të cilin konfirmohet se Aplikuesi ka dorëzuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj Rregulle, në bazë të të cilit Aplikuesi mund të fillojë ndërtimin e Projektit Energjetik;
- 1.4. “Vendim” – nënkupton një dokument formal me shkrim të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së, i cili konstaton përmbushjen e suksesshme nga Aplikuesi të të gjitha kërkesave që dalin nga kjo Rregull;
- 1.5. "Projekti Energjetik" - i referohet bashkërisht projekteve që ndërlidhen me ndërtimin e Kapacitete të Reja Gjeneruese, duke përfshirë Vetë-konsumimin nga Burimet e Ripërtërishme, Sistemet e Reja për Transmisionin dhe Distribucionin e Gazit, duke përfshirë Interkonektorët, Tubacionet Direkte të Energjisë Termike dhe Linjat Direkte të Energjisë Elektrike dhe Tubacionet Direkte për Transmisionin e Gazit Natyror;
- 1.6. “Projekte të Infrastrukturës Energjetike” – janë projektet që kanë të bëjnë me ndërtimin e Sistemeve të Reja për Transmisionin dhe Distribucionin e Gazit, duke përfshirë Interkonektorët, dhe Tubacionet Direkte të Energjisë Termike, Linjat Direkte të Energjisë Elektrike dhe Tubacionet Direkte për Transmisionin e Gazit Natyror, duke përfshirë Kapacitetet e Reja Gjeneruese;
 - “Sisteme të Reja për Transmisionin dhe Distribucionin e Gazit” – nënkupton çdo rrjet transmissioni, rrjet distribucioni, njësi deponuese në pronësi ose që operohet nga një ndërmarrje e gazit natyror, duke përfshirë vëllimin në sistem (line pack) dhe instalimet e saj që furnizojnë me shërbime ndihmëse dhe ato të ndërmarrjeve të ndërlidhura të nevojshme për sigurimin e qasjes në transmision dhe distribucion;
 - “Interkonektorët” – nënkupton linjën e transmissioinit që kalon ose përshkon kufirin ndërmjet Kosovës dhe Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë, dhe që lidh transmisionin nacional të Palëve Kontraktuese;
 - “Linja Direkte të Energjisë Elektrike” – nënkupton një linjë të energjisë elektrike që lidh një pikë të izoluar të prodhimit me një klient të izoluar ose një linjë të energjisë elektrike që lidh një prodhues dhe një ndërmarrje të furnizimit me energji elektrike për të furnizuar direkt objektet, degët dhe klientët e tyre;
 - “Tubacionet Direkte të Energjisë Termike” – nënkupton tubacionin termik që lidh objektet e ndërmarrjeve të energjisë termike, përkatësisht gjeneratorët termikë me



objektet e njësisive vartëse, apo objektet e konsumatorëve përmes tubacioneve direkte për furnizim me energji termike;

- “Tubacione Direkte të Gazit Natyror” – është një tubacion i gazit natyror, plotësues i sistemit të interkonektuar, që lidh një burim gazi me një konsumator;

- 1.7. “Kapacitete të Reja Gjeneruese” – nënkupton impiantin që prodhon energji elektrike apo energji termike me burim primar nga Energjia e Ripërtërishme ose nga Lëndët Djegëse Fosile;
 - 1.8. “ZRRE” – nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës të cilës i është dhënë autoriteti me ligj për lëshim të Autorizimeve në përputhje me këtë Rregull;
 - 1.9. “Lëndë djegëse fosile” – nënkupton çdo kategori të hidrokarbureve, që mund të përdoren si burim energjie dhe që emiton dioksid karboni kur digjet;
 - 1.10. “Energji e Ripërtërishme” – nënkupton burimet e ripërtërishme të energjisë jofosile, si: energjia e erës, energjia solare, ujërat gjeotermale, energjia e valëve, hidroenergjia, biomasa, gazi nga deponitë e mbeturinave, gazi nga trajtimi i ujërave të zeza, biogazi, si dhe çdo teknologji e ripërtërishme që gjeneron energji elektrike dhe ka certifikatën e institucioneve garantuese për këtë teknologji si të ripërtërishme;
 - 1.11. “Vetë-konsumi nga Burimet e Ripërtërishme” – nënkupton konsumatorin e energjisë elektrike i cili mund të prodhojë energji elektrike për nevojat e veta dhe mund të injektojë tepriçën në rrjet, në përputhje me rregullën përkatëse në fuqi;
 - 1.12. “Leja Ndërtimore” – nënkupton lejen e lëshuar nga organi kompetent që shërben si bazë ligjore për realizimin e ndërtimit në përputhje me Ligjin për Ndërtim;
 - 1.13. “Certifikata e Përdorimit” – nënkupton dokumentin e lëshuar nga një organ kompetent që vërteton përputhjen e ndërtimit me dokumentacionin ndërtimor dhe kodet e aplikuara ndërtimore, dhe që tregon se ndërtimi është i përshtatshëm për përdorim;
 - 1.14. “Studim Fizibiliteti” – nënkupton një vlerësim teknik, financiar dhe mjedisor të projektit;
 - 1.15. “Pëlqim Mjedisor” - nënkupton autorizimin me shkrim i nxjerrë nga autoriteti kompetent në pajtim me Ligjin për Mjedisin, ose aktin nënligjor me qëllim të marrjes së lejes për ndërtim;
 - 1.16. “Leje Mjedisore” - nënkupton dokumentin me shkrim i lëshuar nga autoriteti përgjegjës bazuar në Ligjin për Mjedisin, pas finalizimit të ndërtimit, e kërkuar më qëllim që të filloj operimi i impiantit.
2. Çdo term që nuk është përcaktuar me këtë Rregull duhet të interpretohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Ligjin për Energjinë Nr. 05/L-081, Ligjin për Energjinë Elektrike Nr. 05/L-085, Ligji për Gazin Natyror Nr. 05/L-082 dhe Ligji për Energjinë Termike Nr. 05/L-052.



KREU II PROCEDURA E AUTORIZIMIT

Neni 4 Obligimi për Autorizim

1. Asnjë person fizik apo juridik nuk mund të ndërtojë Projekt Energjetik pa marrë Autorizimin nga ZRRE-ja. Ndërtimi i Projektit Energjetik mund të fillojë vetëm pas nxjerrjes së Vendimit me shkrim për Autorizim nga ZRRE, në përputhje me kushtet e këtij Rregulli.
2. ZRRE do të shqyrtojë Aplikimet për Autorizim të paraqitura në përputhje me këtë Rregull dhe do të sigurojë që shqyrtimi i Aplikacionit bëhet në mënyrë objektive, transparente dhe jo-diskriminuese.
3. Procedura dhe kriteret e zbatuara nga ZRRE publikohen në faqen e internetit të ZRRE-së.

Neni 5 Aplikimi për Autorizim

1. Aplikimi për marrjen e Autorizimit do t'i dorëzohet në ZRRE në formë të shkruar, në kopje fizike ose elektronike siç ZRRE e vlerëson të përshtatshme.
2. ZRRE shqyrton Aplikacionin bazuar në kushtet dhe kriteret e këtij Rregulli dhe do të nxjerrë:
 - 2.1. Vendimin për lëshimin e Autorizimit,
ose
 - 2.2. Vendimin për refuzimin e Autorizimit.

Neni 6 Kriteret e Autorizimit

1. Autorizimi për ndërtimin e Projektit Energjetik i jepet personit fizik ose juridik, i cili është i regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Aplikuesi që aplikon për Autorizim sipas këtij Rregulli duhet të respektojë të gjitha ligjet, aktet normative dhe rregullat në fuqi gjatë gjithë kohës.
3. Aplikuesi kur aplikon për Autorizim duhet të ofrojë dëshmi se:
 - 3.1. Posedon kapacitete teknike dhe financiare, burime materiale dhe njerëzore për përmbushjen e kërkesave ligjore dhe rregullative;
 - 3.2. Posedon të drejta pronësore ose të drejta ligjore aty ku do të bëhet ndërtimi;
 - 3.3. Ofron deklaratë se do ti përmbush kushtet e sigurisë dhe mbrojtjes në punë;
 - 3.4. Është në përputhje me kërkesat e Nenit 8, paragrafit 3, nën-paragrafit 1.3 të kësaj Rregulle.



4. Aplikuesi do të sigurojë që Projekti Energjetik i propozuar plotëson kriteret e mëposhtme:
 - 4.1. Promovon një treg konkurrues të energjisë në tregut e brendshëm;
 - 4.2. Ofron mbrojtjen dhe sigurinë e sistemit elektroenergjetik, instalimeve dhe pajisjeve përkatëse;
 - 4.3. Siguron arritjen e zbatimit të standardeve për mbrojtje dhe siguri për personelin, pajisjet, instalimet, makineritë dhe mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet minimale të BE-së;
 - 4.4. Siguron plotësimin e kërkesave për efikasitet të energjisë, përdorimin e pajisjeve më të fundit dhe pajisjet për instalim të jenë të reja (të papërdorura);
 - 4.5. Siguron që ka furnizim adekuat të burimit të energjisë (e aplikueshme për Kapacitetet e Reja Gjeneruese të bazuara në lëndë djegëse fosile).
5. ZRRE mund të kërkojë dëshmi mbështetëse për të konfirmuar se kërkesat sipas Nenit 6 të kësaj Rregulle janë përmbushur.

KREU III PROCEDURA PËR LËSHIM TË AUTORIZIMIT

Neni 7 Aplikimi për Autorizim

1. Aplikacioni për marrjen e Autorizimit për ndërtim të Kapaciteteve të Reja Gjeneruese do t'i dorëzohet ZRRE-së në formë të shkruar, në kopje fizike, ose elektronike siç ZRRE e vlerëson të përshtatshme, sipas Aneksit 1 të kësaj Rregulle, që përmban dokumentet e kërkuara sipas Nenit 8 të kësaj Rregulle.
2. Aplikacioni për marrjen e Autorizimit për Kapacitete të Reja Gjeneruese për Vetë-konsum nga Burimet e Ripërtërishme do t'i dorëzohet ZRRE-së, në formë të shkruar, në kopje fizike, ose elektronike siç ZRRE e vlerëson të përshtatshme, sipas Aneksit 2 të kësaj Rregulle, dhe përmban dokumentet e kërkuara sipas Nenit 9 të kësaj Rregulle.
3. Aplikacioni për marrjen e Autorizimit për projektet e Infrastrukturës Energjetike do t'i dorëzohet ZRRE-së në formë të shkruar, në kopje fizike, ose elektronike siç ZRRE e vlerëson të përshtatshme, sipas Aneksit 3 të kësaj Rregulle, që përmban dokumentet e kërkuara sipas Nenit 10 të kësaj Rregulle.
4. Aplikacioni duhet qartësisht të theksojë personin e autorizuar i cili do ta prezantojë Aplikuesin tek ZRRE.

Neni 8 Aplikimi për Autorizim për ndërtimin e Kapacitete të Reja Gjeneruese



1. Aplikacioni për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese duhet të përmbajë këto dokumente:
 - 1.1. Certifikatën e biznesit të lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë, duke përfshirë vendimin e bordit të kompanisë për përfaqësuesin e autorizuar për Aplikim;
 - 1.2. Dëshmi mbi mundësitë financiare të Aplikuesit, dhe të kompanisë amë, duke përfshirë raportet financiare, siç kërkohen me ligjin për Kontabilitetin, Raportet Financiare dhe Auditimin, varësisht nga klasifikimi i ndërmarrjes;
 - 1.2.1. Dëshmi mbi kapacitetin financiar sipas Nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 nënkuptoj se Aplikuesi posedon të paktën dhjetë (10%) përqind të vlerës së investimit. Kjo dëshmi duhet të mbështetet me deklaratat bankare të lëshuara jo më herët se pesë (5) ditë nga data e Aplikimit.
 - 1.3. Certifikatën e solvencës të biznesit të Aplikuesit, duke përfshirë edhe certifikatën e solvencës së biznesit të kompanisë amë, e lëshuar nga gjykata kompetente, ku dëshmohet se Aplikuesi apo kompania amë nuk është në falimentim;
 - 1.4. Dëshmi nga organet tatimore se Aplikuesi, përfshirë kompaninë amë, nuk ka obligime tatimore;
 - 1.5. Dëshmi mbi të drejtat pronësore dhe ligjore të pronës ku do të ndërtohen Kapacitetet e Reja Gjeneruese;
 - 1.6. Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar, për projekt me kapacitet të instaluar mbi 1 MW;
 - 1.7. Parakontrata ose Kontrata për Projektim, Prokurim dhe Ndërtim (EPC);
 - 1.8. Plani i biznesit që përmban parametrat teknikë të projektit dhe planin financiar që përshkruan mënyrën e financimit, duke përfshirë koston totale të investimit dhe mënyrën e financimit; vlerësimin ekonomik dhe financiar të projektit duke përfshirë pasqyrat financiare; vlerësimin statik dhe dinamik të investimit (PBP, NPV, IRR dhe BP);
 - 1.9. Akti komunal që konfirmon se Projekti Energjetik i propozuar është i lejuar sipas planeve zhvillimore ose hapësinore të Komunës;
 - 1.10. Marrëveshja për kyçje me operatorin përkatës të sistemit;
 - 1.11. Pëlqimin Mjedisor të lëshuar nga autoriteti përkatës, nëse kërkohet për projektin në fjalë;
 - 1.12. Të drejtat Ujore nëse për projektin në fjalë kërkohet leja ujore në bazë të ligjit për Ujërat e Kosovës;
 - 1.13. Lejen e ndërtimit të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për ndërtim ose nga Komuna përkatëse, varësisht prej autoritetit që lëshon lejen sipas Ligjit të Ndërtimit.



2. Nëse një Aplikues i cili është shpallur fitues në kuadër të një skeme mbështetëse në një procedurë konkurruese ofertuese, siç janë ankandet për energjinë e ripërtëritshme, që zhvillohet nga/apo një entitet tjetër që synon të tërheqë investime në teknologjinë e ripërtëritshme, dorëzon:
 - 2.1. Aktin formal që konfirmon se Aplikuesi është përzgjedhur si ofertues fitues përmes procedurës konkurruese;
 - 2.2. Aplikacionin për Autorizim, duke dorëzuar dokumentet e kërkuara sipas nën-paragrafit 1.9-1.13 të Nenit 8.1 të kësaj Rregulle, me kusht që dokumentet e kërkuara sipas paragrafit 1.1-1.8 të Nenit 8.1 të kësaj Rregulle janë dorëzuar si pjesë e kërkesave të kualifikimit gjatë procedurës ofertuese konkurruese.
3. Aplikuesi do të informojë ZRRE-në në lidhje me çdo ndryshim, që mund të ndodhë gjatë zhvillimit të projektit, në dokumentet e kërkuara sipas nën-paragrafit 1.1 – 1.8 të Nenit 8.1 të kësaj Rregulle. Në rast të një ndryshimi të tillë, Aplikuesi do ta dorëzojë dokumentin origjinal në ZRRE pa vonesë.
4. ZRRE ka të drejtën që në çdo kohë të kërkojë nga Aplikuesi çdo dokument të paraparë me Nenin 8.1 të kësaj Rregulle që e konsideron të nevojshme të rishikohet.

Neni 9

Aplikimi për Autorizim për Ndërtimin e Kapaciteteve të Reja gjeneruese për Vetë-konsumatorët nga Burimet e Ripërtëritshme

1. Aplikacioni për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e projekteve për Kapacitete të Reja gjeneruese për vetë-konsum nga Burimet e Ripërtëritshme duhet të përmbajë këto dokumente:
 - 1.1. Dëshmi nga operatori i sistemit për konsumin vjetor të energjisë;
 - 1.2. Vlerësimi i prodhimit vjetor të kWh nga vetë-gjeneratori i propozuar;
 - 1.3. Marrëveshjen për kycje me operatorin e sistemit;
 - 1.4. Pëlqimi i Komunës për instalimin e pajisjeve për Vetë-konsum, nëse kërkohet me legjislacion përkatës për ndërtim.
2. Për ndërtimin të Kapaciteteve të Reja Gjeneruese për vetë-konsum nga Burimet e Ripërtëritshme nuk kërkohet konsultimi publik.

Neni 10

Aplikimi për Autorizim për Ndërtimin e Projekteve të Infrastrukturës Energjetike

1. Aplikacioni për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e projekteve të Infrastrukturës Energjetike duhet të përmbajë këto dokumente:
 - 1.1. Certifikatën e biznesit e lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë, duke përfshirë vendimin e bordit të kompanisë për përfaqësuesin e autorizuar për Aplikim;



- 1.2. Dëshmi mbi të drejtat pronësore dhe ligjore të pronës ku do të ndërtohen Infrastruktura Energjetike;
- 1.3. Parakontrata ose Kontrata për Projektim, Prokurim dhe Ndërtim (EPC);
- 1.4. Certifikatën e solvencës të biznesit të Aplikuesit, duke përfshirë edhe certifikatën e solvencës së biznesit të kompanisë amë, e lëshuar nga gjykata kompetente, ku dëshmohet se Aplikuesi apo kompania amë nuk është në falimentim;
- 1.5. Aktin komunal që konfirmon se Projekti i infrastrukturës Energjetike lejuar me planet zhvillimore ose hapësinore të Komunës;
- 1.6. Studimin e fizibilitetit teknik dhe financiar;
- 1.7. Një plan biznesi që përmban planin financiar të projektit, si dhe informacione të tjera sikur: koston totale të investimit dhe mënyrën e financimit; vlerësimin ekonomik dhe financiar të projektit duke përfshirë pasqyrat financiare; vlerësimin statik dhe dinamik të investimit (PBP, NPV, IRR dhe BP);
- 1.8. Marrëveshjen e kyçjes me operatorin përkatës të sistemit, nëse është e nevojshme;
- 1.9. Pëlqimin mjedisor të lëshuar nga autoriteti përkatës, nëse ajo kërkohet për objektin e projektit;
- 1.10. Lejen e ndërtimit të lëshuar nga Ministria përgjegjëse për ndërtim nga Komuna përkatëse, varësisht prej autoritetit për lëshimin e lejes sipas ligjit të Ndërtimit.

Neni 11

Forma e dorëzimit të Aplikacionit

1. Aplikacioni me të gjitha dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohet në ZRRE në formë të shkruar në një (1) origjinal dhe në një (1) kopje elektronike. Kur Aplikacioni dorëzohet përmes aplikimit elektronik përmes internetit Aplikuesi dorëzon vetëm një (1) kopje elektronike.
2. Aplikacioni dorëzohet në njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë.
3. ZRRE mban të drejtën që të kërkojë nga Aplikuesi që të përkthejë zyrtarisht çdo dokument në gjuhën zyrtare të Kosovës.

Neni 12

Taksat për Aplikim

1. Me dorëzimin e Aplikacionit për shqyrtimin e dokumenteve për autorizimin për ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese ose për autorizimin për ndërtimin e projekteve të Infrastrukturës



Energjetike, sipas Nenit 8 ose Nenit 10 të kësaj Rregulle, ZRRE lëshon një faturë bazuar në Rregullën për Taksa të ZRRE-së.

2. Aplikuesi dorëzon konfirmimin e pagesës në ZRRE, të lëshuar sipas nenit 12, paragrafit 1 të këtij Rregulli, brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të Aplikacionit.
3. ZRRE do të refuzojë shqyrtimin e Aplikacionit nëse Aplikuesi nuk dorëzon konfirmimin e pagesës, sipas nenit 12, paragrafi 1 të kësaj Rregulle, dhe e njofton Aplikuesin për refuzim që ta shqyrtojë Aplikacionin.
4. Pagesa nuk rimbursohet në rast se Aplikimi refuzohet.

Neni 13 **Publikimi i Njoftimit**

1. Në afat prej tetë (8) ditësh nga dorëzimi i Aplikacionit sipas Nenit 8 ose Nenit 10 të kësaj Rregulle, Aplikuesi bën një njoftim publik në dy (2) media të shkruara online.
2. Njoftimi publik përmban:
 - 2.1. Një përmbledhje të përmbajtjes së Aplikacionit;
 - 2.2. Njoftim që çdo palë e interesuar mund të shprehë interesin e tyre ose të kundërshtojë projektin brenda tetë (8) ditëve kalendarike tek ZRRE-ja, nga data e publikimit. Njoftimi përmban gjithashtu:
 - 2.2.1. adresën elektronike të Aplikuesit ku pala e interesuar mund të marrë më shumë informacione mbi projektin e propozuar;
 - 2.2.2. adresën elektronike të ZRRE-së ku pala e interesuar do të dërgojë komentet.
3. Njoftimi i publikuar mbetet i hapur për tetë (8) ditë të njëpasnjëshme nga data e publikimit.
4. Njoftimi i publikuar sipas Nenit 13, paragrafi 1 i kësaj Rregulle publikohet edhe në ueb-faqen e ZRRE-së.
5. Nëse ZRRE-ja merr ndonjë kundërshtim në lidhje me Aplikacion, ajo do t'i ofrojë një kopje të këtij kundërshtimi Aplikuesit dhe do ta publikojë atë në faqen e internetit të ZRRE-së.
6. ZRRE-ja, nuk do të zbulojë asnjë informacion që mund të konsiderohet konfidencial.
7. Pas përfundimit të periudhës së njoftimit publik, ZRRE-ja informon Aplikuesin se procesi i Aplikimit ka përfunduar dhe shqyrtimi do të fillojë, pa paragjykuar rezultatin e vlerësimit.
8. Qasja në dosjen e Aplikimit, për të cilat Aplikuesi ka lejuar qasje, mundësohet për atë që e lejon legjislacioni për Qasje në Dokumentet Publike.



Neni 14 Dorëzimi i sqarimeve

1. ZRRE ka të drejtë të kërkojë sqarime nga Aplikuesi gjatë gjithë periudhës së shqyrtimit.
2. Në rast se Aplikuesi nuk dorëzon sqarimet e nevojshme, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e parashtrimit të kërkesës për sqarime nga ZRRE dhe në rast se ZRRE konsideron se sqarimi i kërkuar është i nevojshëm për vlerësimin e drejtë të Aplikacionit, ZRRE mban të drejtën të refuzojë Aplikacionin për arsye të Aplikacionit të pa-plotësuar.

Neni 15 Pezullimi i përkohshëm i shqyrtimit

Në rast se ZRRE konsideron se Aplikacioni nuk mund të shqyrtohet për shkak se Bordi i ZRRE-së, nuk ka kuorum të vendimmarrjes, ZRRE informon Aplikuesin se afati i shqyrtimit është pezulluar përkohësisht derisa Bordi i ZRRE-së të, marrë mandatin dhe rrjedhimisht afatet ligjore nuk mund të rrjedhin për shqyrtim.

KAPITULLI IV AFATI PËR SHQYRTIM DHE VLEFSHMËRIA E TË DREJTAVE TË AUTORIZIMIT

Neni 16 Afati për shqyrtim

1. ZRRE shqyrton Aplikacionin për ndërtimin e Kapacitete të Reja Gjeneruese dhe projekteve të Infrastrukturës Energjetike brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike, nga dita kur ZRRE informon Aplikuesin se ka përfunduar procesi i Aplikimit, siç njoftohet në bazë të Nenit 13, paragrafi 7 i kësaj Rregulle.
2. ZRRE shqyrton Aplikacionin për ndërtimin e Kapacitete të Reja Gjeneruese për vetë-konsumimin nga Burimet e Ripërtërishme brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike nga dita e dorëzimit të Aplikacionit në ZRRE.
3. Në rast të aplikacioneve komplekse, në bazë të vlerësimit të ZRRE-së, afati i shqyrtimit mund të vazhdohet edhe për një afat shtesë prej 30 ditësh me njoftim të ZRRE-së.
4. Për shqyrtimin e Aplikacioneve sipas par. 1 të këtij Neni, ZRRE cakton grupin punues në kuadër të ZRRE-së, i përbërë nga tre (3) deri në pesë (5) anëtarë, të cilëve u është dhënë autoriteti për shqyrtimin e Aplikacioneve. Përfaqësuesi nga departamenti juridik i ZRRE-së do të veprojë si kryesues i grupit punues.
5. Grupi punues përgatit një raport me shkrim, i cili në mes tjerash do të përmbajë:
 - 5.1. Aftësitë teknike, ekonomike dhe financiare të Aplikuesit;
 - 5.2. Përputhshmërinë e projektit me strategjinë e energjisë, ose ndonjë dokument tjetër të politikave për burimet e ripërtërishme të energjisë;



5.3. Lokacionin e kapacitetit të ri gjenerues; dhe

5.4. Zgjidhjen teknike për kyçje të rrjet.

Neni 17

Vendimi i ZRRE-së për Autorizim

1. Nëse ZRRE konstaton se Aplikuesi ka përmbushur kërkesat sipas kësaj Rregulle, do të nxjerrë:
 - 1.1. Vendimin për Autorizim, me të cilin vërtetohet e drejta e Aplikuesit për të filluar ndërtimin.
2. Nëse ZRRE-ja konstaton se Aplikuesi nuk i ka përmbushur kërkesat sipas kësaj Rregulli, do të lëshojë:
 - 1.1. Vendimin për refuzimin e Autorizimit, duke paraqitur arsyet për një refuzim të tillë.
3. Aplikuesi informohet për Vendimin nga ZRRE me shkrim.

Neni 18

Garancia financiare

1. Me Vendimin për lëshimin e Autorizimit, ZRRE kërkon nga Aplikuesi që të dorëzojë në ZRRE një garanci financiare, të lëshuar nga një bankë komerciale apo kompani e sigurimeve me vlefshmëri që mbulon periudhën nga lëshimi i Autorizimit deri në përfundimin e ndërtimit të Projektit Energjetik.
2. Garancia financiare dorëzohet në ZRRE brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e lëshimit të Vendimit për Autorizim.
3. Nëse kërkohet një garanci financiare nga një entitet tjetër gjatë zhvillimit të procedurës konkurruese për tërheqjen e investimeve në teknologjinë e ripërtëritshme, siç janë ankandet për energji të ripërtëritshme, ndërsa kjo garanci financiare është efektive deri në përfundimin e ndërtimit të Projektit të Energjisë, Aplikuesit nuk i kërkohet të dorëzojë garanci financiare në ZRRE, sipas kërkesave të kësaj Rregulle.
4. Garancia financiare që do të sigurohet nga Aplikuesi duhet të jetë si më poshtë:
 - 1.1. Për projektet me vlerë deri në €500,000.00, Aplikantët paguajnë një vlerë prej 10% të vlerës së projektit;
 - 1.2. Për projektet me vlerë prej €500,001.00 deri në €1,000,000.00, Aplikantët paguajnë vlerën prej 8% të vlerës së projektit;
 - 1.3. Për projektet me vlerë mbi €1,000,001.00, Aplikantët paguajnë një vlerë prej 7% të vlerës së projektit.



5. Garancia financiare ekzekutohet nga ZRRE pas ndërprerjes në bazë të arsyeve të specifikuara në Nenin 22 të kësaj Rregulle;
6. Garancia financiare mund të tërhiqet nga Aplikuesi vetëm pas përfundimit të ndërtimit. Përfundimi i ndërtimit do të konfirmohet me shkrim nga ZRRE.
7. Nuk kërkohet garanci financiare për Aplikimet për ndërtimin e Kapaciteteve të Reja Gjeneruese për vetë-konsum nga Burimet e Ripërtërishme.

Neni 19 **Vlefshmëria e Autorizimit**

1. Autorizimi i lëshuar nga ZRRE-ja sipas Nenit 17, paragrafi 1 të kësaj Rregulle lëshohet për një periudhë prej njëzet e katër (24) muajsh. Aplikuesi do të ndërtojë Projektin Energjetik brenda kësaj periudhe.
2. Afati sipas paragrafit 1 të këtij Neni, pas kërkesës me shkrim nga Aplikuesit mund të vazhdohet edhe për dymbëdhjetë (12) muaj të tjerë. Arsyet për një zgjatje të tillë duhet të arsyetohen dhe të kenë qenë jashtë kontrollit të Aplikuesit.
3. Aplikuesi pas Aplikimit për Autorizim mund të kërkojë përjashtim nga kërkesa e Nenit 19, paragrafi 1 i kësaj Rregulle. Kur vendos për përjashtim, ZRRE merr parasysh specifikat e projektit, studimin e fizibilitetit dhe informacionin nga projektimi, prokurimi dhe kontrata e ndërtimit. Për çdo rast, kjo periudhë duhet të jetë e arsyeshme sipas planit dinamik të realizimit.

Neni 20 **Finalizimi i Autorizimit**

1. ZRRE do ta konsideroj të Projektin Energjetik të finalizuar pas sjelljes së Certifikatës së Përdorimit për Projektin Energjetik të lëshuar nga organi kompetent sipas Ligjit për Ndërtimin.
2. Leja Mjedisore e lëshuar për Projektin Energjetik për Kapacitete të Reja Gjeneruese, do të jetë kusht për fillimin e operimit komercial.
3. Për Kapacitetet e Reja Gjeneruese me kapacitetet të instaluar mbi 5 MW, para hyrjes në operim komercial, Aplikuesi duhet të pajiset edhe me licencë për prodhim të energjisë elektrike nga ZRRE.

KREU V **MODIFIKIMI DHE PËRFUNDIMI I AUTORIZIMIT**

Neni 21 **Ndryshimi i Autorizimit**

1. Për shkak të ndryshimeve të projektit, apo për ndonjë arsye tjetër të justifikueshme, modifikimi i Autorizimit mund të inicohet nga Aplikuesi ose nga ZRRE.



2. Modifikimi, i nxjerrë me Vendim të veçantë, nuk do të ndërpresë apo modifikojë afatin e Autorizimit të miratuar në bazë të Nenit 19 të kësaj Rregulle.
3. Modifikimi i Autorizimit bëhet me njoftim publik, sipas Nenit 13 par. 2 të kësaj Rregulle.

Neni 22 Ndërprerja e Autorizimit

1. Autorizimi mund të ndërpritet në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara në Vendimit për Autorizim nga ZRRE.
2. ZRRE mund ta ndërpresë Autorizimin nëse:
 - 2.1. Afati i autorizimit ka përfunduar, dhe i autorizuari nuk ka parashtruar kërkesë për shtyrje apo nuk e ka finalizuar ndërtimin e Projektit Energjetik;
 - 2.2. Mbjtësi i Autorizimit shkel kushtet e përcaktuara në Vendimin e Autorizimit, legjislacionin në fuqi dhe/ose rregulla të tjera;
 - 2.3. Aplikuesi nuk e dorëzon garancinë financiare brenda afateve sipas kësaj Rregulle;
 - 2.4. Lëshimi i Autorizimit është bërë në bazë të informacionit të rremë; dhe
 - 2.5. Një vendim gjyqësor e ka shpallur mbajtësin e Autorizimit josolvent dhe/ose ka ndërprerë veprimtarinë e tij.
3. Pas ndërprerjes së Autorizimit, ZRRE ekzekuton Garancinë Financiare sipas Nenit 18 të kësaj Rregulle.

KREU VI DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 23 Aplikimet ekzistuese

1. Nëse një aplikim për ndërtimin e Kapacitete të Reja Gjeneruese të bazuara në burime të ripërtëritshme është pranuar nga ZRRE-ja sipas Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapacitete të Reja Gjeneruese të bazuara në Burime të Ripërtëritshme të Energjisë (Rregulla ZRRE/Nr./11/2017) para hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle, një aplikim i tillë shqyrtohet në përputhje me Rregullën në fuqi në kohën e aplikimit.
2. Çdo Aplikim pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulle shqyrtohet nga ZRRE sipas kësaj Rregulle.

Neni 24 Të drejtat për ankesë

1. Vendimi i nxjerrë nga ZRRE mund të apelohe me padi në Gjykatën kompetente.



2. Padia nuk e ndërpret ekzekutimin e Vendimit.

Neni 25

Transparenca

1. Çdo Vendim për Autorizim publikohet në ueb-faqen e ZRRE-së.
2. Me miratimin e Vendimit, ZRRE informon Komunën (at) përkatëse ku ndodhet Projekti Energjetik dhe institucionet relevante që kanë lëshuar pëlqimet dhe lejet përkatëse.
3. Në rast të refuzimi të Autorizimit, arsyet e refuzimit të tillë bëhen publike.
4. ZRRE përditëson rregullisht bazën e të dhënave të Aplikacioneve.

Neni 26

Komunikimi me Autoritetet Qendrore dhe Lokale

ZRRE komunikon dhe bashkëpunon me autoritetet qendrore dhe lokale, si dhe me operatorët e sistemit.

Neni 27

Monitorimi

ZRRE monitoron Aplikuesit duke kërkuar raporte të zbatimit të Projekteve Energjetike dhe viziton fizikisht lokacionet ku ndodhet Projekti Energjetik dhe monitoron implementimin e kërkesave të parapara me Vendim për Autorizim.

Neni 28

Licencimi i prodhimit

1. Për projektet bazuar në Kapacitete të Reja Gjeneruese me kapacitet më të lartë se 5 MW, me rastin e sjelljes së Certifikatës së Përdorimit dhe të Lejes Mjedisore, ZRRE do të lëshoj licencën e prodhimit bazuar në dëshmitë të dorëzuara me Aplikacionin për Autorizim.
2. ZRRE mban të drejtën të kërkojë dokumente apo dëshmi shtesë nga Aplikuesi gjatë dhënies së licencës për prodhim.

Neni 29

Gjuha zyrtare

Kjo Rregull publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Në rast mospërputhjes ndërmjet versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën Shqipe.



Neni 30
Ndryshimet/Plotësimet

1. ZRRE ka të drejtë të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedura për ndryshimin ose modifikimin e kësaj Rregulle do të jetë e njëjtë si për miratimin e saj.

Neni 31
Interpretimi

Nëse ka paqartësi rreth dispozitave të kësaj Rregulle, Bordi i ZRRE-së, do të nxjerrë informacione shpjeguese.

Neni 32
Hyrja në fuqi


1. Rregulla hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.
2. Rregulla publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


~~Bordi i ZRRE-së:~~


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Izet Rushiti, Anëtar


Selman Hoti, Anëtar


Lutfije Dervishi, Anëtar


Gani Buçaj, Anëtar



ANEKSI 1: Aplikimi për Kapacitete të Reja Gjeneruese

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR APLIKUESIN		
EMRI I APLIKUESIT (PERSONI JURIDIK):		
ADRESA:		
REGJISTRIMI NR.		
TELENONI:		
E-MAIL:		
EMRI DHE MBIEMRI I PERSONIT KONTAKTUES:		
ADRESA:		
TELENONI:		
E-MAIL:		
INFORMACION SPECIFIK RRETH PROJEKTIT TË INFRASTRUKTURËS ENERGETIKE		
LLOJI I PROJEKTIT	KAPACITETET E REJA GJENERUESE: (a) Burimet e ripërtëritshme të energjisë; (b) Lëndë djegëse fosile	<input type="checkbox"/> <input type="checkbox"/>
Vendndodhja dhe Koordinatat	Komuna(atë)	Informacion specifik mbi projektin (kapaciteti i instaluar, lloji i teknologjisë, prodhimi vjetor i vlerësuar, etj.)



Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhen bashkëngjitur:	Shkruaj: Po ose Jo	
		PO	JO
1.	Certifikata e Biznesit, përfshirë edhe vendimin e bordit të kompanisë për përfaqësuesin e autorizuar për Aplikim		
2.	Dëshmi mbi aftësinë financiare të Aplikuesit dhe të kompanisë amë se posedon të paktën dhjetë përqind (10%) të vlerës së investimit. Kjo dëshmi duhet të mbështetet me dëshmi bankare të lëshuara jo më herët se pesë (5) ditë prej datës së Aplikimit		
3.	Certifikatën e solvencës të biznesit të Aplikuesit, duke përfshirë edhe certifikatën e solvencës së biznesit të kompanisë amë, e lëshuar nga gjykata kompetente, ku dëshmohet se Aplikuesi apo kompania amë nuk është në falimentim		
4.	Vërtetim nga Autoriteti Tatimor		
5.	Dëshmi mbi të drejtat e pronësore dhe ligjore		
6.	Studimi teknik dhe financiar i fizibilitet, për projektin me kapacitet të instaluar mbi 1MW		
7.	Parakontrata ose Kontrata për Inxhinieri, Prokurim dhe Ndërtim (EPC)		
8.	Plani i biznesit që përmban parametrat teknike të projektit dhe planin financiar (siç kërkohet sipas Nenit 8, paragrafi 1, nënparagrafi 1.8)		
9.	Akti i Komunës (duke konfirmuar se projekti lejohet të zbatohet në komunën përkatëse dhe është në përputhje me planin zhvillimor komunal)		
10.	Marrëveshja e kyçjes me operatorin përkatës të sistemit sipas nivelit të tensionit		
11.	Pëlqimi Mjedisor e lëshuar nga subjekti përkatës, nëse kërkohet për objektin e projektit		
12.	Të Drejtat Ujore (nëse kërkohet)		
13.	Leja e Ndërtimit dhe planin dinamik të realizimit		



ANEKSI 2: Aplikimi për ndërtimin e Kapacitete të Reja Gjeneruese për vetë-konsumatorët me Burimeve të Ripërtërishme

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI APLIKUESIN		
EMRI I APLIKUESIT (PERSONI JURIDIK):		
ADRESA:		
REGJISTRIMI NR.		
TELENONI/		
E-MAIL:		
EMRI DHE MBIEMRI I PERSONIT KONTAKTUES:		
ADRESA:		
TELENONI/		
E-MAIL:		
INFORMACION SPECIFIK RRETH PROJEKTIT TË INFRASTRUKTURËS ENERGETIKE		
LLOJI I PROJEKTIT	KAPACITETI I RI I GJENERIMIT PËR VETËKONSUMIMIN E BURIMEVE TË RIPËRTËRITSHME	<input type="checkbox"/>
Vendndodhja dhe Koordinatat	Komuna	Informacion specifik mbi projektin

Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhen bashkëngjitur:	Shkruaj: Po ose Jo
------------	--	-------------------------------



		PO	JO
1.	Dëshmi nga operatori i sistemit mbi konsumin vjetor të energjisë		
2.	Vlerësimi i prodhimit vjetor të kWh të Vetë-gjeneratorit të propozuar		
3.	Marrëveshja e kyçjes me operatorin e sistemit		
4.	Pëlqimi i Komunës për instalimin e pajisjeve vetë-konsumuese të Ripërtëritshme, nëse kërkohet me legjislacion përkatës për ndërtim.		



ANEKSI 3: Aplikimi për projektet e Infrastrukturës Energjetike

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI APLIKUESIN		
EMRI I APLIKUESIT (PERSONI JURIDIK):		
ADRESA:		
REGJISTRIMI NR.		
TELENONI/:		
E-MAIL:		
EMRI DHE MBIEMRI I PERSONIT KONTAKTUES:		
ADRESA:		
TELENONI/:		
E-MAIL:		
INFORMACION SPECIFIK RRETH PROJEKTIT TË INFRASTRUKTURËS ENERGETIKE		
LLOJI I PROJEKTIT	1. Sisteme të reja për transmisionin dhe distribucionin e gazit;	<input type="checkbox"/>
	2. Interkonektorë;	<input type="checkbox"/>
	3. Linjat direkte të energjisë elektrike;	<input type="checkbox"/>
	4. Tubacionet direkte të energjisë termike;	<input type="checkbox"/>
	5. Tubacionet direkte të gazit natyror	<input type="checkbox"/>
Vendndodhja dhe Koordinatat	Komuna(të)	Informacion specifik për projektin e Infrastrukturës Energjetike

Nr.	Dëshmitë/dokumentet që duhen bashkëngjitur:	Shkruaj:
-----	---	----------



		Po ose Jo	
		PO	JO
1.	Certifikatën e biznesit e lëshuar nga Agjencia për Regjistrimin e Biznesit në Kosovë, duke përfshirë vendimin e bordit të kompanisë për përfaqësuesin e autorizuar për Aplikim		
2.	Dëshmi mbi të drejtat pronësore dhe ligjore		
3.	Parakontrata ose Kontrata për Projektim, Prokurim dhe Ndërtim (EPC)		
4.	Certifikatën e solvencës të biznesit të Aplikuesit, duke përfshirë edhe certifikatën e solvencës së biznesit të kompanisë amë, e lëshuar nga gjykata kompetente, ku dëshmohet se Aplikuesi apo kompania amë nuk është në falimentim		
5.	Akti komunal (duke konfirmuar se projekti lejohet të zbatohet në komunën përkatëse)		
6.	Studimi i fizibilitetit teknik dhe financiar i projektit		
7.	Plan Biznesi (siç kërkohet me Nenin 10, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7)		
8.	Marrëveshja e Kyçjes me Operatorin e Sistemit (nëse kërkohet)		
9.	Pëlqimi Mjedisor		
10.	Leja e Ndërtimit dhe planin dinamik të realizimit		